



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 107 dt. 11.11.2014

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.11.2014, pasi shqyrtoi problematikën e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, mbi vjedhjen e kontraforteve metalike të jashtme në anën jugore të monumentit “Kisha e Manastirit të Shën Kollit”, Mesopotam,

VENDOSI:

1. Miratohet vendosja e kontraforteve metalike të jashtme në anën jugore të monumentit “Kisha e Manastirit të Shën Kollit”, Mesopotam, nga DRKK Vlorë, sipas projektit të miratuar.
2. Objekti të merret në dorëzim nga DRKK Vlorë.
3. IMK dhe DRKK Vlorë, të punojnë për hartimin e një projekti, duke rivlerësuar projektet e mëparshme dhe gjendjen aktuale të objektit.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI